

LIGJ
Nr.8362, datë 1.7.1998

**PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E GJYKATËS SË KASACIONIT DHE
ADMINISTRIMIN E SHËRBIMEVE GJYQËSORE**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
ORGANIZIMI I GJYKATËS SË KASACIONIT

Neni 1

Gjykata e Kasacionit përbëhet nga kryetari, zëvendëskryetarët, kryetarët e kolegjeve dhe gjyqtarët.

Gjykata e Kasacionit organizohet në këto kolegje: civil, penal, administrativ dhe tregtar.
Çështjet ushtarake gjykohen nga Kolegji Penal i Gjykatës së Kasacionit.

Neni 2

Kryetari, zëvendëskryetari dhe kryetarët e kolegjeve përbëjnë kryesinë e Gjykatës së Kasacionit, e cila ushtron kompetencat e parashikuara në këtë ligj.

Gjykata e Kasacionit përfaqësohet nga kryetari i saj.

Neni 3

Krijimi i kolegjeve dhe ndarja e gjyqtarëve në to, do të bëhet nga mbledhja e përgjithshme e gjyqtarëve, duke respektuar kriteret e specializimit dhe të ngarkesës së punës për çështjet përkatëse.

Zëvendëskryetarët janë kryetarë të kolegjeve në të cilët bëjnë pjesë.

Kolegjet e tjera zgjedhin nga përbërja e tyre kryetarin për një afat 3 vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje.

Neni 4

Gjykata e Kasacionit gjykon me trup të përbërë prej tre gjyqtarësh të të njëjtit kolegji. Kur formimi i trupit gjykues është i pamundur, kryetari i Gjykatës cakton me short gjyqtarë të kolegjeve të tjera.

Kur kryetari i kolegjit merr pjesë në gjykim, ai kryeson trupin gjykues, përveç rasteve kur është relator i çështjes, në të gjitha rastet e tjera kryesuesi caktohet me rotacion.

Neni 5

Kolegjet e Gjykatës së Kasacionit kanë këto kompetenca:

Kolegji Civil gjykon rekurset:

a) në çështjet civile, sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurës Civile, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe me ligj të veçantë;

b) në të gjitha rastet e tjera që nuk u janë dhënë me ligj në kompetencë kolegjeve të tjera.

Kolegji Penal gjykon rekurset:

- në çështjet penale sipas përcaktimit të Kodit të Procedurës Penale ose të ligjeve të veçanta.

Kolegji Tregtar gjykon rekursët:

- kundër vendimeve të dhëna në çështjet tregtare në rastet e parashikuara me ligj.

Kolegji Administrativ gjykon rekursët:

- në çështjet administrative në rastet e parashikuara me ligj.

Neni 6

Çdo kolegji, sipas kompetencës së tij, ka të drejtë të vendosë për:

a) kërkesat lidhur me transferimin e çështjeve në përputhje me kodet e procedurave;

b) çdo kërkesë tjetër që parashikon ligji.

Neni 7

Gjykata e Kasacionit vendos në kolegje të bashkuara:

a) në rastet e parashikuara në kodet e procedurave;

b) për rekursët kundër vendimeve të kolegjeve të saj të dhëna në shkallë të parë;

c) për ankimin kundër vendimeve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Neni 8

Kur Gjykata e Kasacionit gjykon në kolegjet e bashkuara, seancën e kryeson kryetari i saj.

Në mungesë të tij, kryetari cakton një nga zëvendëskryetarët.

Kolegjet e bashkuara gjykojnë kur në to marrin pjesë jo më pak se dy të tretat e gjyqtarëve.

Mendimet merren me shumicën e gjyqtarëve të pranishëm.

Neni 9

Kolegjet e bashkuara kanë të drejtë, gjatë gjykimit të çështjeve konkrete, të marrin vendim për unifikimin ose modifikimin e praktikës gjyqësore.

Në këtë rast vendimi unifikues i kolegjeve të bashkuara ka fuqi detyruese për të ardhmen për gjykatat e shkallëve me të ulta.

Vendimi unifikues i praktikës gjyqësore mund të merret:

a) kur kërkohet nga secili kolegji i Gjykatës së Kasacionit;

b) kur çështja tërhiqet për këtë qëllim nga kryetari i Gjykatës së Kasacionit;

c) kur kolegjet e bashkuara çmojnë se duhet marrë një vendim i tillë.

Neni 10

Vendimet unifikuese botohen në Fletoren Zyrtare.

Vendimet unifikuese u dërgohen gjykatave të tjera jo më vonë se 15 ditë nga shpallja e tyre.

Vendimet e tjera përfundimtare botohen në buletin e Gjykatës së Kasacionit.

Neni 11

Kolegji e ndërpret gjykimin dhe vendos shqyrtimin e çështjes në kolegjet e bashkuara, kur gjatë gjykimit të çështjes vërtetohet një nga kërkesat e parashikuara në ligj.

Në rast se kolegjet e bashkuara vendosin për mospranimin, atëherë çështja i kthehet kolegjit përkatës për gjykim.

Neni 12

9. Prokurori i Përgjithshëm merr pjesë në kolegjet e bashkuara në rastet e parashikuara në nenin

Kur ka pengesë ligjore, si dhe në mungesë të tij, ai delegon një nga zëvendësit.

Neni 13

Kryesia ka edhe këto të drejta:

- a) I propozon kryetarit emërimin dhe masat disiplinore për këshilltarët e kolegjeve dhe ndihmësit e gjyqtarëve.
- b) I jep mendimin për kandidaturat e gjyqtarëve për në Gjykatën e Kasacionit.

Neni 14

Kryesia i propozon mbledhjes së përgjithshme të anëtarëve të Gjykatës së Kasacionit që, për rastet e parashikuara në dispozitat kushtetuese, t'i kërkojë Kuvendit Popullor fillimin e procedurës së shkarkimit, të një gjyqtari të Kasacionit.

Neni 15

Me përjashtim të çështjeve që rregullohen me këte ligje, këshilltarët e Gjykatës së Kasacionit gëzojnë statusin e gjyqtarit të apelit.

Këshilltarët mund të përzgjidhen nga radhët e gjyqtarëve, prokurorëve dhe avokatëve, të cilët duhet të kenë vjetërsi profesioni jo më pak se 5 vjet.

Këshilltarët trajtojnë ankesat, tërheqin dosjet, bëjnë studimin e tyre dhe përgatitin përgjigjet e materialet e tjera, japin mendime, si dhe ndihmojnë kolegjet në punën e tyre.

Neni 16

Gjykata e Kasacionit, në mbledhjet e përgjithshme të anëtarëve të saj, përcakton rastet që kërkojnë përmirësim të legjislacionit dhe ia njofton ato Këshillit të Ministrave.

Neni 17

Gjatë vakancës gjyqësore një numër gjyqtarësh i caktuar nga kryesia gjykon:

- a) çështjet me të arrestuar;
- b) çështjet e tjera që konsiderohen të ngutshme sipas ligjit ose që çmohen të tilla qoftë edhe nga një anëtar i kryesisë, i cili qëndron në detyrë.

Mënyra e caktimit të këtyre gjyqtarëve bëhet me short, sipas kritereve të përcaktuara në rregulloren e brendshme të Gjykatës së Kasacionit.

Neni 18

Kryetari i Gjykatës së Kasacionit emëron stafin e tij, të cilët kryejnë detyra të përcaktuara në rregulloren e brendshme.

Në mbledhjet e saj Kryesia e Gjykatës së Kasacionit ndihmohet nga stafi i kryetarit.

Gjyqtari i Kasacionit, në ushtrimin e detyrës, ka një ndihmës dhe një sekretar, të cilët përgjigjen drejtpërdrejt përpara tij.

KREU II ADMINISTRIMI I SHËRBIMEVE GJYQËSORE

Neni 19

Funskionet e administrimit të shërbimeve gjyqësore në Gjykatën e Kasacionit ushtrohen nga kancelari nën autoritetin e kryetarit të saj.

Kancelari ka në kompetencë:

- a) organizimin dhe administrimin e shërbimeve gjyqësore, në të cilat hyjnë sekretari gjyqësorë dhe sektori i administrimit të dokumenteve;
- b) marrjen në punë të personelit administrativo-teknik të këtyre shërbimeve, me pëlqimin

Kryesisë së Gjykatës;
c) organizimin e shortit gjyqësor.

Neni 20

Kancelar mund të emërohet juristi me stazh pune jo më pak se 7 vjet në një profesion të tillë.
Kancelari emërohet dhe shkarkohet nga Presidenti i Republikës, me propozimin e Kryesisë së Gjykatës së Kasacionit.

Neni 21

Në Gjykatën e Kasacionit funksionojnë sekretaria gjyqësore, sektorë të administratës, ekonomisë, informatizimit e dokumentacionit, departamenti i marrëdhënieve me jashtë dhe departamenti i studimeve.

Për shërbime të tjera ndihmëse Kryesia e Gjykatës së Kasacionit mund të hapë zyra të veçanta.

Neni 22

Për mirëmbajtjen e rendit, si dhe ruajtjen e saj, Gjykata e Kasacionit ka të drejtën e disponimit të forcave policore që janë në shërbim të saj.

Kryesia përcakton numrin e nevojshëm të forcave policore, të cilat janë nën urdhrat e kryetarit të Gjykatës së Kasacionit.

KREU III DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 23

Për çështje të tjera që nuk parashikohen nga ky ligj, zbatohen dispozitat e ligjit nr.8265, datë 18.12.1997 "Për organizimin e Drejtësisë në Republikën e Shqipërisë".

Neni 24

Detajet e organizimit dhe funksionimit të Gjykatës së Kasacionit parashikohen në rregulloren e brendshme të saj, të miratuar nga mbledhja e përgjithshme e anëtareve të kësaj Gjykate.

Për zbatimin e këtij ligji ngarkohet kryetari i Gjykatës së Kasacionit.

Neni 25

Ndarja e Gjykatës së Kasacionit në kolegje, të bëhet jo më vonë se 60 ditë nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 26

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2148, datë 9.7.1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani